Shoqata e Juristëve të Rinj të Maqedonisë

Procesi i vlerësimit të ndikimit rregullativ në vitin 2017

Analizë e implementimit të procesit të vlerësimit të ndikimit rregullativ (VNRr) nga ministritë e Republikës së Maqedonisë në vitin 2017
Shkup, shtator 2018

IDSCS | Институт за демократија Социетас цивилис - Скопје

CEA Center for Economic Analyses

Македонско здружение на млади правници

Projekti është i financuar nga Bashkimi Europian

Titulli:
Procesi i vlerësimit të ndikimit rregullativ në vitin 2017-Analizë e implementimit të procesit të vlerësimit të ndikimit rregullativ (VNRr) nga ministritë e R.M-së në vitin 2017
Botuesi:
Shoqata e Juristëve të Rinj të Maqedonisë
Autorë:
Svetlana Crvenkovska
Goce Kocevski
Përkthim:
Suzana Çavolli
Lekturë:
Suzana Çavolli
Dizajni:
Ani Arandjelovic

Analiza është pjesë e programit për nën-grantim në kuadër të projektit Vlerësimi i ndikimit të rregullativës nën hije: promovimi i krijimit të politikave të bazuara në dëshmi. Projekti financohet nga Bashkimi Evropian"

„Ky publikim është përgatitur me ndihmën e Bashkimit Europian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e Shoqatës së Juristëve të Rinj të Maqedonisë dhe në asnjë mënyrë nuk i pasqyron qëndrimet e Bashkimit Europian.

Përmbajtja

Lista e shkurtesave 7
1. Vërejtjet hyrëse 9
1.1 Objekti dhe qëllimi i analizës 9
1.2 Metodologjia e përdorur 10
1.3 Procesi për VNRr 11
2. Zhvillimi i procesit për VNRr në vitin 2017 12
2.1 Vërejtje të përgjithshme 12
2.2 Zhvillimi i procesit për VNRr nga ana e ministrive në vitin 2017 14
2.2.1 Ministria e Mbrojtjes 14
2.2.2 Ministria e Punëve të Brendshme 14
2.2.3 Ministria e Drejtësisë 16
2.2.4 Ministria e Punëve të Jashtme 18
2.2.5 Ministria e Financave 19
2.2.6 Ministria e Ekonomisë 21
2.2.7 Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Administrimit të Ujrave 23
2.2.8 Ministria e Shëndetësisë 24
2.2.9 Ministria e Arsimit dhe Shkencës 24
2.2.10 Ministria e Punës dhe Politikës Sociale 25
2.2.11 Ministria e Vetëqeverisjes lokale 26
2.2.12 Ministria e Kulturës 27
2.2.13 Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës 27
2.2.14 Ministria e Transportit dhe Lidhjeve 28
2.2.15 Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor 28
2.3 Problemet dhe sfidat në zbatimin e procesit të VNRr-së pamje nga brenda 29
3. Praktikat më të mira në zbatimin e VNRr-së - Analiza krahasuese 30
3.1 Zbatimi dhe rëndësia e VNRr-së në BE 30
3.2 VNRr në Francë 32
3.3 VNRr në Mbretërinë e Bashkuar 33
3.4 VNRr në Slloveni 33
3.5 VNRr në Kroaci 35
4. Konkludime dhe rekomandime përfundimtare 36
Aneksi 1: Literatura e përdorur 39
Aneksi 2: Pyetësori i përdorur 40
Aneksi 3: Një mostër e kërkesës së paraqitur për qasje të lirë në informacion publik 41

Lista e shkurtesave

VNRr	Vlerësimi i ndikimit rregullativ
RM	Republika e Maqedonisë
BE	Bashkimi Evropian
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior
OECD	Organizata për Bashkpunim dhe Zhvillim
RVKE	Regjistri i Vetëm Kombëtar Elektronik
OQ	Organizatat qytetare
QRM	Qeveria e Republikës së Maqedonisë
MShIA	Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë
MB	Ministria e Mbrojtjes
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MD	Ministria e Drejtësisë
MPJ	Minsitria e Punëve të Jashtme
MPPS	Ministria e Punës dhe Politkës Sociale
MTL	Minsitria e Transportit dhe Lidhjeve
MBPAU	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Administrimit të Ujërave
ME	Ministria e Ekonomisë
MF	Ministria e Financave
MVL	Ministria e Vetëqeverisjes Lokale
MMJPH	Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor
MSH	Ministria e Shëndetsisë

1. Vërejtje hyrëse

1.1 Objekti dhe qëllimi i analizës

Analiza e aplikimit të procesit të ndikimit të rregullativës në vitin 2017 (në tekstin e më tutjeshëm: Analiza) analizon dhe vlerëson veprimet e ministrive në zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga vlerësimi i ndikimit të rregullativës. Analiza synon të identifikojë nëse dhe në çfarë mase ministritë gjatë vitit 2017, në zhvillimin e projekt-ligjeve brenda departmaneteve të tyre, janë përqëndruar në Udhëzimin për mënyrën e e veprimit në punën e ministrive në procesin e zbatimit të Vlerësimit të ndikimit të rregullativës[1] dhe me Metodologjinë përkatëse për Vlerësimin e Ndikimit të Rregullativës[2].

Në vlerësimin e pajtueshmërisë, Analiza i kushton vëmendje të barabartë formalitetit dmth. obligimet procedurale (p.sh. zbatimin e aktiviteteve, afateve, obligimit për informim), si dhe kërkesat thelbësore në lidhje me cilësinë e dokumentave të përpiluara dhe tërësinë e analizave që janë pjesë e detyrueshme të procesit të VNRr.

Përveç kësaj, Analiza bën përpjekje, që me ndihmën analizës dhe krahasimit të sistemeve dhe modeleve të ndryshme për zbatimin e VNRr-së, të identifikojë praktikat më të mira dhe zgjidhjet që mund të zbatohen në Maqedoni, dhe të cilat do të mund të ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në kualitetin e procesit për VNRr. Praktikat dhe zgjidhjet më të mira të identifikuara do të përmbushin gjetjet dhe konkluzionet e analizës së procesit për VNRr në vitin 2017 dhe do të kontribuojë për formulimin e rekomandimeve për përmirsimin e ktij procesi shumë të rëndësishëm për të forcuar cilësinë e legjislacioniot, dhe si rrjedhojë e kësaj edhe sigurinë ligjore të qytetarëve.

Analiza bazohet në hulumtime të kryera më parë, punime dhe dokumente të cilat analizojnë procesin për VNRr. Gjetjet e përbashkëta të të gjitha këtyre dokumenteve thojnë se edhe se kanë kaluar thuajse dhjetë vite nga fillimi i zbatimit të procesit për VNRr, ka mangësi serioze për shkak të së cilave nuk ka dhënë rezultatet e duhura, e as, nuk i përmbushi qëllimet për të cilat ajo u miratua. Analiza ka të bëjë edhe me punën e mëparshme rë Shoqatës së Juristëve të Rinj të Maqedonisë (ShJRM). Në vitin 2011, ShJRM-ja përpiloi dhe publikoi analizë për cilësinë dhe mënyrën e zbatimit të pocesit për vlerësimin e ndikimit të rregullativës.[3] Analiza merr parasysh informacionet e rregullta vjetore, progesin dhe zbatimin e VNRr-së që i përpilon MShIA, kryen analizë objektive të të dhënave që përmbahen aty, por gjithashtu shkon edhe një hap më tutje duke ndërhy në cilësinë e dokumenteve të përgatitura në kuadër të VNRr-së.

Analiza është bërë nga Svetlana Cërvenkovska, koordinator për hulumtime dhe analiza si dhe Goce Kocevski, koordinator për ndihmë juridike dhe avokimit strategjik në Shoqatën e Juristëve të Rinj të Maqedonisë. Analiza është përgatitur në kuadër të proektit "Me VNRr cilësore deri në një legjislativ më cilësore në RM" i zbatuar nga ShJRM dhe mbështetur nfa Instituti për demokraci "Societas Civilis" Shkup në kuadër të programës "Vlerësimi i ndikim rregullativ nën hije: Promovimi i krijimit të politikave bazuar në prova", mbështetur financiarisht nga Bashkimi Evropian.

1 Gazeta Zyrtare e R.M-së, nr. 106, datës 29.7.2013.
2 Gazeta Zyrtare e R.M-së, nr. 107, datës 30.7.2013 r.

3 Brezovska J., Korunovska A.N., Danilovsla B.D., Analiza e procesit të krijimit të rregullativave përmes përgatitjes së Vlerësimit të ndikimit të rregullativës, Shoqata e Juristëve të Rinj të Maqedonisë, 2011.

1.2 Metodologjia e përdorur

Tema e hulumtimit është veprimi i ministrive në procesin e zbaitmit të vlerësimit të ndikimit të rregullativës në vitin 2017. Analiza i ka këto objektiva të kërkimit: (1) të përcaktojë nëse dhe në çfarë mase ministritë kanë vepruar në përputhje me Udhëzimin dhe Metodologjinë e VNRr-së; (2) t'i identifikonë problemet kyçe që pengojnë ose kufizojnë procesin për VNRr; (3) të bëjë rekomandime të zbatueshme bazuar në praktikat më të mira për rritjen e cilësisë së procesit të zbatimit të VNRr-së.

Gjatë hulumtimit është përdorur metodë e kombinuar për të mbledhur të dhënat primare dhe sekundare dhe për t'i analizuar ato përmes treguesve të elaboruar në mënyrë kualitative dhe kuantitative. Për nevojat e hulumtimit janë përdorur mjetet e mëposhtme për mbledhjen e të dhënave:

- Analiza e dokumenteve (desk research), e cila përbëhej nga pasqyrimi dhe analiza e dokumenteve të mëposhtme:
  - o Rregulloret me të cilat rregullohet procesi për VNRr;
  - o Raportet e MShIA-së që kanë të bëjnë me procesin për VNRr, të botuara në web-faqen e Ministrisë;
  - o Kërkimi në dokumentet e botuara në web-faqen e RVKE-së[4];
  - o Literaturë tjetër relevante, doracak, udhëzues, udhëzime, raporte në lidhje me procesin për VNRr në R.M;
  - o Rregulloret dhe raportet që kanë të bëjnë me VNRr-në e shteteve të cilat janë objekt i analizës komparative.
- Dorëzimi i kërkesave për qasje të lirë në informata të karaterit publik[5] tek të gjitha ministritë, me të cilat kërkohet qasje në dokumentet që kanë të bëjnë me proceset e VNRr-së që kanë filluar në vitin 2017;
- Pyetsor i strukturuar anonim, me të cilin mblidhen informacione nga koordinatorët e VNRr-së në çdo ministri, në lidhje me problemet dhe sfidat me të cilat ballafaqohen ministritë gjatë procesit për VNRr.

Informacionet e grumbulluara janë të analizuara për çdo ministri veçmas, në bazë të një kornize të përgatitur të indikatorëve, e cila kornizë mundëson të përcaktohet nëse ministritë kanë vepruar sipas Udhëzimit dhe Metodologjisë dhe deri në çfarë mase. Indikatorët janë të ndarë në dy gurpe. Grupi i parë ka të bëjë me respektimin e dispozitave formale (procedurale) të përcaktuara në Udhëzim, nëdrsa grupi i dytë i indikatorëve ofron mundësi për të shqyrtuar nëse analizat e nevojshme, si dhe konsultat me palët e prekura janë duke u zhvilluar në mënyrë thelbësore. Gjatë analizës është përcaktuar nëse indikatorët e paraparë janë të plotësuar dhe deri në çfarë mase. Analiza është bërë me ndihmën analizimit dhe kqyrjes së Hartim raporteve dhe hartim raporteve të botuara në RVKE, duke i krahasuar të njëjtat me të dhënat e marra nga çdo ministri veçmas, si dhe informacionet e MShIA-së lidhur me VNRr-në[6].

a. Indikatorët në lidhje me ploëtsimin e kërkesave formale

- Ministria ka të botuar Plan vjetor të VNRr-së për vitin 2017 dhe i përmbahet të njëjtit;
- Ministria ka zhvilluar proces të VNRr-së gjatë hartimit të çdo ligji, përveç atyre që, sipas Rregullores, janë të përjashtuara nga VNRr-ja;
- Ministria ka zhvilluar të gjitha aktivitetet e planifikuara sipas mënyrës dhe afatit të përcaktuar në Udhëzim;
- Të gjitha dokumentet janë të botuara në RVKE;
- Palët e prekura janë të informuara me kohë për fillimin e procesit për VNRr përmes një njoftimi të botuar në RVKE, i cili i përmban të gjitha elementet e nevojshme.

4 https://ener.gov.mk/
5 Ekzemplar i kërkesës – Aneksi 4.
6 Informacion për progresin – vlerësimi i ndikimit rregullativ (VNRr) (janar-dhjetor 2017), dhe Pasqyra e respektimit të obligimeve që dalin nga procesi i VNRr-së dhe publikimi i detyrueshëm i ligjeve në RVKE (janar-dhjetor 2017).

b. Indikatorët në lidhje me plotësimin e kërkesave esenciale

- Përshkrimi i gjendjes dhe analiza e problemeve janë të qarta dhe të detajuar në raportin e VNRr-së, përfshirë këtu të dhëna relevante statistikore, demografike etj, duke u thirrur në analiza dhe raporte të përgatitura tashmë;
- Objektivat e rregullativës janë konkrete, realisht të realizueshme dhe të matshme;
- Raportet përmbajnë së paku tre zgjidhje të mundshme të problemeve të indentifikuara, si dhe të njëjtat janë mirë të elaboruara;
- Përfitimet dhe ndikimi i rregullativës janë të identifikuara në bazë të disa analizave të bëra dhe të njëjtat janë të elaboruara dhe të mbështetura si duhet;
- Është zhvilluar procesi konsultativ duke u dhënë mundësi të gjitha palëve të prekura të përfshihen në këtë proces, si dhe është dhënë përgjigje në lidhje me komentet dhe propozimet e marra;
- Është paraparë kornizë e indikatorëve për monitorim dhe vlerësim të ligjit.

Në aspektin kohor, objekti i hulumtimit të proceseve të VNRr-së, të cilat kanë filluar dhe janë zhvilluar gjatë vitin 2017, është i kufizuar.

1.3 Procesi për VNRr

Procesi për VNRr ka filluar në vitin 2009, mirëpo në vitin 2013, me miratimin e Udhëzimit dhe Metogologjisë nga Qeveria e R.M-së, ka pësuar disa ndryshime të caktuara. Procesi i vlerësimit të rregullativës (VNRr) paraqet një proces ku, me ndihmën e metodave konsistente analitike, bëhet përcaktimi dhe vlerësimi sistematik i ndikimeve të prituara të propozim-rregullativës. VNRr-ja paraqet një proces komparativ i cili bazohet në përcaktimin e objektivave të rregullativës, si dhe gjetjen e mënyrave të mundshme për ti arritur ato, në mënyrë që sistematikisht të zgjedhet mënyra më efikase dhe më efektive për të arritur objektivin e propozim-rregullativës[7].Në të vërtetë, krijimi i politikave efikase është parakusht esencial për një sundim të mirfillt të ligjit[8], ndërsa rregullativa është bazë për funksionimin e duhur të shoqërisë dhe ekonomisë, si dhe është e domosdoshme për mbrojtjen e tyre[9].

Duhet të theksohet se procesi për VNRr është i rëndësisë së veçantë në kontekstin e prioriteteve të R.M-së për antarësimin në BE dhe NATO, për arsye se në periudhën para-antarësimit procesi i harmonizimit të legjislacionit të R.M-së me atë të BE-së dhe shteteve anëtare të NATO-së nënkupton një analizë të akteve ligjore të këtyre vendeve dhe transpozim në legjislacionin kombëtar. Në rast të fillimit të bisedimeve për antarësimin e vendit në BE, atëhere procesi për VNRr do të jetë edhe më i rëndësishëm, përshkak se përmes këtij procesi mund të përcaktohet ndikimi afat-gjatë dhe afat-shkurtër i akteve ligjore të BE-së në sistemin ligjor kombëtar. Në të njëjtën kohë, kjo mundëson që vendi të ketë një pozitë më të volitshme në porcesin e bisedimeve, si dhe të zvogëlohen ndikimet negative ndaj R.M-së[10].

Qëllimi kryesor që synohet të arrihet përmes procesit për VNRr është të sigurohen informata të sakta dhe relevante për ndikimet pozitive dhe ato negative që dalin nga mënyrat e mundshme të zgjidhjes së problemit, si dhe për mënyrat e propozuara për arrtijen e objektivave të projekt-ligjit. Një zhvillim cilësor i procesit për VNRr kontribuon në zbatimin efektiv dhe efikas të ligjit, dhe në këtë mënyrë në zbatimin e politikave të Qeverisë[11].

Kryesisht, procesi për VNRr zbatohet sipas parimit të proporcionalitetit, dmth. niveli i analizës dhe kompleksiteti i mejeteve analitike të përdorura në kuadër të procesit varen nga ndikimi i pritur i projekt-ligjit. Qasja analitike si dhe thellësia e analizës mund të ndryshoj varësisht nga rëndësia e çështjeve që rregullohen me projekt-ligjin[12].

7 MShIA, Doracak për vlerësimin e ndikimit rregullativ, tetor, 2013, fq. 10.
8Shikova N, Model për analizë të efektivitetit të vlerësimit të ndikimit rregullativ, ID-SCS, CEA, gushtë, 2017, fq. 3.
9 Doracak për vlerësimin e ndikimit rregullativ, fq. 8.
10 Metodologjia e vlerësimit të ndikimit të rregullativës.
11 Ibid. Fq. 5.
12 MShIA, Doracak për vlerësimin e ndikimit rregullativ, tetor, 2013, fq. 11.

Sipas Rregullores së Punës së Qeverisë së RM-së[13], procesi për VNRr zhvillohet për të gjitha projekt-ligjet të cilat dërgohen në Qeveri për shqyrtim dhe konstatim, me përjashtim të ligjeve për të cilat zhvillohet procedurë urgjente, ligjet për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, ligjet me të cilat bëhet harminizimi terminologjik me ligjet e tjera, ligjet për Buxhetin, si dhe ligji për ekzekutimin e Buxhetit të R.M-së[14].

Procesi për VNRr zhvillohet në tre faza. Në fazën e parë, e quajtur si planifikim strategjik, Qeveria dhe ministritë relevante bëjnë analizë të rrethanave dhe të rregullativës, përcaktojnë problemet të cilat mund të ekzistojnë në rregullativën ligjore, si dhe bëjnë analizë të ndikimeve (ekonomike, sociale, fiskale dhe ndikmet në mjedisin jetësor). E gjithë kjo përmblidhet dhe publikohet në Planin vjetor të punës së Qeverisë dhe në Planin vejtor të VNRr-së, pastaj këto të njëjtat dokumente publikohen në RVKE[15]

.

Në fazën e dytë zhvillohet një numër i madh i aktviteteve, si: 1) njoftimi i palëve të prekura për fillim e procesit; 2) analizimi i rrethanave dhe definimi i objektivave; 3) përcaktimi i zgjidhjeve të mundshme; 4) analizë rreth ndikimit të çdo opsioni dhe pastaj definimi i zgjidhjes optimale; 5) në rast se konstatohet se egziston nevoja për zbatimin e një mase rregullative, përgatitet një projekt-ligj si dhe një plan për monitorimin dhe vlerësimin e tij; 6) përgatitja e projekt-rapotit të VNRr-së, publikimi i tij në RVKE dhe dorëzimi i të njëjtit për mendim në MShIA; dhe 7) përgatitja e propozim-raportit të VNRr-së dhe firmosja e të njëjtit nga ana e ministrit përkatës[16]. Ajo që është e përbashkët për shumicën e aktiviteteve të veçanta të fazës së dytë është zhvillimi i konsultave me palët e prekura. Ato janë pjesë përbërëse e procesit për VNRr dhe paraqesin një mekanizëm shumë të rëndësishëm për përmirësimin e cilësisë së rregullativës, si dhe ndikojnë në rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit në zbatimin e masave të parapra[17].

Faza përfundimtare e procesit për VNRr përbëhet nga vendimmarrja. Në këtë fazë, projekt-ligji dhe propozim-raporti për VNRr dërgohen në Sekretariatin GjRVKEal të Qeverisë së R.M-së, nga ana e Qeverisë përcaktohet projekt-ligji dhe, së bashku me raportin e VNRr-së, i njëjti publikohet në RVKE. Pas kësaj faze vijon zbatimi, monitorimi dhe vlerësimi i ligjeve të miratuara në përputhje me planin e miratuar[18].

2. Zhvillimi i procesit për VNRr në vitin 2017

2.1 Vërejtje të përgjithshme

Procesi për VNRr në vitin 2017 në masë të madhe ka qenë nën ndikimin e kontekstit socio-politik në të cilin është gjendur vendi në atë periudhë. Duke filluar nga viti 2015, kur Republika e Maqedonisë po përballej me një krizë të thellë politike dhe me institucione të bllokuara, aktiviteti legjislativ u ngadalsua, ndërsa për një periudhë të caktuar kohore terësisht edhe u stopua. Gjatë kësaj periudhe, proceset kryesore të reformimit, si dhe projektet ligjore u pezulluan, kështuqë nevoja për zhvillimin e proceseve të VNRr-së ishte minimale. Për këtë arsye, nga gjithësej 15 ministri, vetëm 6 prej tyre kishin përpiluar dhe botuar plan vjetor të VNRr-së për vitin 2017. Në fillim të vitit 2017, Republika e Maqedonisë pothuajse katër muaj ngeli pa pushtet ekzekutiv legjitim si rezultat i krizës politike e cila eskaloi me ngjarjet e 27 prillit. Qeveria e re u zgjodh në qershor të vitit 2017, prandaj dhe aktivitetet kryesore të VNRr-së u zhvilluan vetëm në pjesën e dytë të vitit.

13 „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 38/01, 98/02, 9/03, 47/03, 64/03, 67/03, 51/06, 5/07, 15/07, 26/07, 30/07, 58/07, 105/07, 116/07, 129/07, 157/07, 29/08, 51/08, 86/08, 114/08, 42/09, 62/09, 141/09, 162/09, 40/10, 83/10, 166/10, 172/10, 95/11, 151/11, 170/11, 67/13, 145/14, 62/15, 41/16 dhe 153/16.

14 Neni 8, paragrafi 1, pika 7 e Rregullores së Punës së Qeverisë së R.M-së.

15 Metodologjia e vlerësimit të ndikimit të rregullativës, pika 2.1.

16 Ibid.

17 Ibid

18 Ibid.

Karakteristikë e aktiviteteve legjislative të zhvilluara gjatë vitit 2017 është fokusi i tyre në përmbushjen e rekomandimeve të BE-së që dalin nga Prioritetet urgjente të reformave dhe nga Raporti i gurpit të ekspertëve të lartë për çështje sistemore të sundimit të ligjit në lidhje me ndjekjen e komunikimeve (i ashtuquajtur Raporti i Pribe-së). Këto rekomandime u inkorporuan në Planin 3-6-9 të Qeverisë dhe të njëjtat u ngritën në nivelin më të lartë të prioriteteve. Sa i përket reformave të tjera, ka filluar një proces intensiv i planifikimit dhe përpilimit të dokumenteve strategjike (p.sh. gjyqësor, administratë publike etj.), të cilat do ta diktojnë aktivitetin legjislativ gjatë viteve në vijim.

Në vitin 2017, edhe pse ishin të planifikuara gjithësej 48 procese të VNRr-së, megjithatë, pjesërisht për shkak të rrethanave të krijuara, por edhe për shkak të mungesës së një planifikimi të mirfillt, filluan gjithësej 92 procese të VNRr-së. Në vitin 2017, Qeveria miratoi gjithësej 54 projekt-ligje të cilat i nënshtrohen VNRr-së.

Pasqyrë e proceseve të filluara të VNRr-së dhe projekt-ligjet e miratuara të cilat i nënshtrohen procesit për VNRr në vitin 201719:

Ministria	VNRr të planifikuara	VNRr të filluara	Adopted by the Government
MM	0	3	1
MPB	0	7	5
MD	7	9	11
MF	12	9	7
MPJ	0	18	0
MBPAU	1	1	1
MSh	20	12	1
MASh	1	1	2
MPPS	6	3	0
MVL	0	5	10
MK	0	0	0
MshIA	0	7	6
MTL	0	10	9
	0	3	1
MMJPH	1	4	0
Gjithësej:	**48**	**92**	**54**

19 Të dhënat janë grumbulluar nga këqyrja në RVKE, si dhe nga Pasqyra e MShIA-së për përmbushjen e obligimeve të cilat dalin nga procesi i VNRRr-së për periudhën janar-dhjetor 2017..

2.2 Zhvillimi i procesit për VNRr nga ana e ministrive në vitin 2017

2.2.1 Ministria e Mbrojtjes

MM-ja nuk ka të përpiluar dhe të botuar Plan vjetor të VNRr-së për arsye se në planin e punës për vitin 2017 nuk është paraparë ndryshim apo plotësim e ligjve në sferën e mbrojtjes[20]. Megjithatë, gjatë këtij viti ka filluar procesi për VNRr për projekt-ligjin për ndryshimin e Ligjit për informacionin e klasifukuar. Nevoja për intervenim vjen nga rekomandimet e Raportit të Pribe-së. Në vitin 2017 kanë filluar dhe janë zhvilluar proceset e VNRr-së me të cilat bëhet ndryshimi dhe plotësimi i dy ligjeve të tjera, mirëpo të njëjtat nuk janë të miratuara nga ana e Qeverisë në vitin 2018.

Ligji për plotësimin e Ligjit për informacionin e klasifikuar

Nga pikëpamja formale, ministria ka respektuar procesin për VNRr, me përjashtim të asaj se hartim raporti për VNRr për projekt-ligjin është (spe kuptoj). Gjithashtu, propozim-raporti për VNRr nuk është i botuar në RVKE. Hartim raporti është mjfat i mangët dhe nuk len hapsirë për të analizuar cilësinë e procesit për VNRr

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtje dhe shpëtim, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e krizave

Me këto dy ligje bëhet ndërhyrje minore në lidhje me kushtet e përcaktuara me keto ligje që duhet t'i plotësojnë bartësit e funksioneve publike. Në aspektin formal, procesi për VNRr është respektuar, megjithatë nuk kemi një propozim-raport të botuar në RVKE, ndërsa hartim raportet, me përjashtim të përshkrimit të gjendjes dhe objektivave të rregullativës, janë tejet të mangëta për të bërë një analizë më serioze.

2.2.2 Ministria e Punëve të Brendshme

Plani i vjetor i VNRr-së për vitin 2017 për këtë ministri nuk është i botuar me arsyetimin se shkaqet e mospublikimit janë të natyrës teknike[21]. Në vitin 2017, procesi për VNRr filloi për gjithësej shtatë ligje[22], pesë prej të cilave janë miratuar nga ana e Qeverisë së R.M-së si propozim- ligje.

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për sigurinë në komunikacionin rrugor

Me ndryshimet e propozuara të ligjit, MPB-ja ka për synim përmirësimin e përmbajtjes, përkatësisht përmirësimin normativo-ligjor dhe teknik të tekstit, me qëllim përmirësimin e zbatueshmërisë së tij. Ndryshimi është relativisht voluminoz dhe përfshinë më shumë se 90 nene të ligjit, nga gjithësej 414 nene. Ligji është miratuar në vitin 2018, mirëpo propozim-raporti për VNRr nuk është i botuar në RVKE. Proejtk-raporti është mjfat i mangët në lidhje me përshkrimin e gjendjes dhe arsyeve për miratimin e ndryshimit. Objektivat janë shumë të përgjithshme për të qenë të realizueshme dhe të matshme. Sa i përket vlerësimit rregullativ, raporti është më i avancuar. Janë të identifikuara ndikimet e mundshme, mirëpo nuk kemi analiza dhe raporte të duhura për t'i mbeshtetur ato. Në lidhje me konsultat, duke patur parasysh se bëhet fjalë vetëm për një hartim raport, nuk ka të dhëna të mjaftueshme mbi bazën e të cilave mund të nxirren konklusione.

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për armët

Arsyet për miratimin e këtij ligji janë si rrjedhojë e nevojës për precizmin tekniko-terminologjik të disa prej dispozitave të ligjit, si dhe për tejkalimin e problemeve me të cilat hasen shërbimet kompetente. Me këtë propozim bëhet ndërhyrje në pothuajse 1/3 e dispozitave të ligjit bazik. Për arsye nomoteknike kishte me qenë më e përshtatshme të miratohej një ligj krejtësisht i ri sesa të ndryshohet dhe të plotësohet i njëjti[23]. Ligji është miratuar në vitin 2018, mirëpo propozim-raporti për VNRr nuk është i botuar në RVKE. Përshkrimi i gjendjes dhe i objektivave në lidhje me harmonizimin e rregullativave relevante të BE-së është i duhur, ndërsa sa i takon pjesës tjetër, përshkrimi është shumë i përgjithshëm dhe jo i saktë.

21 Informacion i MPB-së nr. 16.1.2-1216/1, datës 14.05.20181

22 Vërejtje: Në RVKE, Kodi i procedurës penale është publikuar si ligj i propozuar nga MPB-ja, mirëpo nga këqyrja në njoftimin mund të kuptojmë padyshim se bëhej fjalë për një gabim teknik.

23 Sekretariati për legjislativë, Qeveria e R.M-së, Doracak për rregullat nomoteknike, Shkup 2007, fq. 32.

Nuk kemi përshkrim të tri zgjidhjeve të mundshme. Në vend të kësaj, është përshkruar vetëm zgjidhja e propozuar. Sa i përket vlerësimit rregullativ, raporti është më i avancuar. Janë të identifikuara ndikimet e mundshme, mirëpo nuk kemi analiza dhe raporte të duhura për t'i mbeshtetur të njëjtat. Në lidhje me konsultat, duke patur parasysh se bëhet fjalë vetëm për një hartim raport, nuk ka të dhëna të mjaftueshme mbi bazën e të cilave mund të përfundohet nese ato janë zvhilluar në përputhje me Udhëzimin dhe Metodologjinë.

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për policinë, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për punë të brendshme

Këto ligje janë pjesë e grupit të ligjeve të hartuara me qëllim krijimin e një mekanizmi të pavarur për të kontrolluar punën e policisë. Ndërhyrja në këto ligje është minore dhe ajo i referohet vetëm parashikimit të detyrimit për të informuar departamentin e sapo formuar në Prokurorinë Publike, në rast të marrjes dijeni për vepra penale të kryera nga persona me kompetenca policore, si dhe rregullimit të disa çështjeve të caktuara që kanë të bëjnë me përgjegjësinë disiplinore. Ligjet janë të miratuara në vitin 2018, mirëpo, ashtu si edhe të mëparshmet, propozim – raportet e VNRr-së nuk janë të botuara në RVKE. Në esencë, hartim raportet i plotësojnë kërkesat e Udhëzimit dhe Metodologjisë.

Ligji për mbrojtje ndërkombëtare dhe mbrojtje të përkohshme

Me këtë ligj, krejtësisht të ri, bëhet harmonizimi i legjislacionit me direktivat e BE-së në fushën e azilit. Për fat të keq, edhe në këtë rast nuk është botuar propozim- raporti për VNRr, kështuqë analiza është e bazuar në projekt- raportin. Përshkrimi i kushteve dhe përkufizimi i problemit është shumë i mangët dhe formal pa të dhëna statistikore apo referenca në analiza dhe raporte të caktuara. Nga ana tjetër, duke patuar parasysh se bëhet fjalë për një harmonizim normativ me direktivat e BE-së, objektivat e ligjit gjithësesi se janë të realizueshme dhe të matshme. Mungojnë tre zgjidhje të mundshme të problemit. Vlerësimi i ndikimit rregullativ, ndonëse i pranishëm, por pa argumente të mjaftueshme për t'i mbështetur konklusionet. Procesi konsultativ është i planifikuar si duhet, mirëpo pasi që është vetëm një hartim raport, nuk mund të përfundohet se si është i zbatuar në praktikë. Në RVKE janë të botuara përgjigjet në lidhje me komentet e marra, nëse ato janë të pranuara apo jo dhe cilat janë arsyet për këtë.

Ligji për ndjekjen e komunikimeve, Ligji për Agjencinë Teknike Operative

Përmes këtyre dy ligjeve zbatohen rekomandimet e një grupi të lartë të ekspertëve për çështje sistemore të sundimit të ligjit lidhur me ndjekjen e komunikimeve (Raporti i Pribe-së). Këto ligje janë të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, mirëpo propizim- raport i VNRr-së është botuar vetëm për Ligjin për ndjekjen e komunikimeve. Sa i përket procesit për VNRr, nga kërkimi e të dyja raporteve, mund të përfundohet se është respektuar procedura e përcaktuar në Udhëzim. Procesi i konsultave është zhvilluar duke përfshirë të gjitha palët e prekura, si dhe janë të botuara propozimet e pranuara dhe arsyet për mos pranimin e disa prej tyre. Ato që mungojnë janë tri zdhidhjet e mundshme, si dhe një analizë më e detajuar për ndikimin e rregullativës, veçanërisht në aspekt të resurseve financiare dhe ato njerëzore të nevojshme për zbatimin e tyre.

2.2.3 Ministria e Drejtësisë

Sipas Planit vjetor të VNRr-së, kjo ministri për vitin 2017 kishte planifikuar të hartojë shtatë ligje, por përshkak të rrethanve të reja, të krijuara me ndërrimin e qeverisë dhe impenjimeve të marra për reforma gjyqësore, nga ana e qeverisë janë përcaktuar 11 projekt-ligje. Sipas të dhënave të marra nga RVKE-ja dhe nga evidenca e MShIA-së është konstatuar se: në RVKE janë të botuara nëntë ligje , ndërsa për mendim në MShIA janë dërguar tetë hartim raporte të VNRr-së, prej të cilave njëri është dërguar në po të njëjtën datë kur edhe është botuar në RVKE – që është në kundërshtim me procedurën e VNRr-së. Nga gjithsej 11 ligjet e dërguara në QRM, për dy nga ato nuk është zhvilluar proces i VNRr-së (Ligji për përdorimin e gjuhëve dhe Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal), që është në kundërshtim me Rregulloren dhe Udhëzimin, ndërsa për një tjetër, në qeveri nuk është dërguar fare raport i VNRr-së (Ligji për amnestinë).

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve

problemeve është i detajuar, adresohen të gjitha rrethanat relevante dhe citohen analizat dhe raportet e botuara. Objektivat janë të realizueshme dhe të matshme, ndërsa të propozuara janë më

shumë se tri zgjidhje. Raporti gjithashtu përmban një përshkrim të hollësishëm të llojeve të ndryshme të ndikimeve të të gjitha opsioneve të propozuara. Megjithatë, sa i përket ndikimeve fiskale, raporti vlerëson se ligji do të ketë ndikime fiskale, por pa vlerësuar se sa do jenë ato. Nga ana tjetër, shpenzimet për zbatimin dhe respketimin e rregullativës janë hollësisht të vlerësuara. Raporti identifikon të gjitha palët e prekura relevante, si dhe përshkruan mënyrën e përfshirjes së tyre (grup punues, debat publik, këqyrje publike përmes RVKE-së). Gjithashtu, raporti përmban një përshkrim të komenteve të marra dhe të inkorporuara, si dhe arsyetim për komentet e painkorpuruara. Raporti përmban kornizë të detajuar të indikatorëve për monitorim dhe vlerësim të ligjit.

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për përmbarim

Me këtë ligj, Ministria kishte për synim sqarimin dhe përmirësimin e mënyrës së testimit për kualifikimin si përmbarues dhe shpalljes së konkursit për përmbarues, të rregulloj më tej pjesëmarrjen e detyrueshme të avokatëve në procedurat përmbarimore për kërkesat që tejkalojnë shumën prej 10.000 euro, të adresohet sistemi i ndërlikuar dhe i shtrenjtë për zbatimin e procedurës për pagesa jashtëgjyqësore të borxheve, si dhe të revidohet mënyra e monitorimit. Lidhur me këtë ndryshim, sipas RVKE-së, procedura e VNRr-së ka ngecur në procedurën e hartim raportit. Përshkrimi i gjendjes dhe i problemeve përmban një përshkrim të redaktimit të çështjes e jo të problemeve të mundshme të cilat duhet të adresohen. Problemet janë pjesërisht të identifikuara, mirëpo mungon specifikimi i problemeve dhe sqarimi se cilat janë pasojat që vijnë nga ato. Objektivat e projekt-ligjit nuk janë të shprehura në mënyrë precize (ridefinimi i kornizës ligjore nuk është qëllim në vetvete. Është e nevojshme të tregohet objektivi që duhet të arrihet me këtë ndryshim). Mungojnë tri zgjidhje të mundshme, ndërsa edhe ato që janë dhënë nuk janë të sakta (miratohet projekt-ligj pa sqaruar se çka në fakt ndryshohet). Me përjashtim të ndikimeve ekonomike, sipas raportit, por pa iu referuar analizave, nuk do të ketë ndikime tjera. Procesi konsultativ i përmbush kërkesat e procesit për VNRr.

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për noterinë

Objektivat e këtij ligji kanë të bëjnë me ridefinimin e procedurës për emërimin e noterëve, si dhe rritjen e efikasitetit dhe uljen e shpenzimeve për lëshimin e një urdhërpagese noteriale. Projekt-raporti i plotëson kushtet deri në një masë të caktuar, megjithatë është shumë i mangët sa i takon përshkrimit të konsultave të planifikuara dhe atyre të realizuara, si dhe ndikimit rregullativ.

Ligji për amnisti
Ligji për amnisti kishte për qëllim të zvogëlojë numrin e të burgosurve në Republikën e Maqedonisë, duke ulur kështu mbipopullimin e burgjeve, që u vlerësua si shkak i trajtimit çnjerëzor dhe degradues të të burgosurve. Procesi për VNRr për këtë ligj është i zbatuar në tërësi, me përjashtim, sipas MShIA-së, raporti për VNRr nuk është dërguar fare në qeveri. Hartim raporti për VNRr, i botuar në RVKE, është i mangët sa i takon përshkrimit të gjendjes dhe problemeve që duhet zgjidhur. Përshkrimi nuk përmban të dhëna në lidhje me numrin e të burgosurve në Republikën e Maqedonisë dhe strukturën e tyre, numrin e INP-ve dhe cilat prej tyre janë të mbipopulluara etj. Gjithashtu, përshkrimi nuk i referohet analizave apo raporteve në lidhje me nevojat për të miratuar një ligji të këtillë. Objektivi i ligjit, që ka të bëj me resocializimin, është i kufizuar në aspekt të fizibilitetit. Raporti nuk përmban tre zgjidhje të mundshme, ndërkaq përshkrimi i ndikimeve, veçanërishtë atyre sociale, është i mangët dhe i njëjti nuk bazohet në analiza, por në supozime. Megjithatë, procesi konsultativ është i kënaqshëm.

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve
Propozimi për miratimin e këtij ligji vjen si rrjedhojë e nevojës për një autonomi substanciale të prokurorit special publik nga PBRM-ja në procedurat për përcaktimin e statusit të dëshmitarit të mbrojtur. Procesi VNRr-së për këtë ligj është zhvilluar në mënyrën e duhur. Përshkrimi i gjendjes dhe i problemeve, si dhe identifikimi i tyre, është i plotë dhe i saktë. Objektivat janë të realizueshme dhe të matshme. Mungojnë tri zgjidhje, por gjithashtu mungon edhe një vlerësim i hollësishëm i ndikimeve fiskale të këtij ligji. Procesi konsultativ është zhvilluar në mënyrë të kënaqshme, mirëpo mungojnë indikatorët për monitorimin dhe vlerësimin e ligjit.

Ligji për shfuqizimin e Ligjit për Këshillin për verifikimin e fakteve dhe ngritjen e procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë së gjykatësit
Nevoja për miratimin e këtij ligji, i cili kishtë për qëlllim shuarjen e këtij organi shtetëror, vjen si pasojë e vërejtjeve të Komisionit të Venecias. Meqenëse ky organ do shuhej, nuk ishte e nevojshme të zhvillohet një proces i thellë i VNRr-së edhe pse i njëjti është respektuar formalisht. Ky proces do të zhvillohet gjatë hartimit të ndryshimeve dhe plotësimeve të Këshillit gjyqësor, i cili do ta ushtrojë funksionin që kishte Këshilli për verifikimin e fakteve.

Ligji për ndihmë juridike falas
Ministria, me propozim, hartoi një tekst si propozim për një tekst krejtësisht të ri të Ligjit për ndihmë juridike falas. Në vitin 2017 është zhvilluar faza e parë e procesit për VNRr për këtë ligj dhe përfshinte hartimin e një projekt-teksti të ligjit dhe një hartim raport të VNRr-së. Përshkrimi i gjendjes dhe i shkaqeve të problemeve është shumë i qartë, si dhe përmban të dhëna dhe analiza të mirfillta. Tek objektivat, në vend të formulimit të tyre, është prezentuar përmbajta e ligjit. Raporti nuk përmban të paktën tri zgjidhje të politikave. Sa i përket ndikimeve, është identifikuar, shkurtimisht por saktë, se ligji do ketë ndikim (social, fiskal dhe ekonomik), megjithatë ky ndikim nuk është i vlerësuar dhe i arsyetuar. Në lidhje me konsultat, edhe pse të planifikuar në kuadër të projekt-fazës, megjithatë ato janë zhvilluar në fazat e mëvonshme. Mungojnë indikatorët për monitorim dhe vlerësim të ligjit.

Projekt-ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale
Procedura e VNRr-së për këtë ligji filloi në vitin 2017 me publikimin e një njoftimi, mirëpo nga kërkimi në uebfaqen RVKE, si dhe nga të dhënat e disponueshme mund të përfundohet se procedura nuk është vazhduar më tej.

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbimin prokurorial publik
Synimi kryesor, për çka dhe filloi procesi i hartimit të këtij ligji, është të krijohen të ashtuquajturat qendra hetimore në kuadër të prokurorive publike. Procesi për VNRr ka filluar në vitin 2017 dhe i njëjti ka përfunduar në vitin 2018. Hartim raporti, sa i përket përshkrimit të gjendjes, problemeve dhe objektivave, është i plotësuar në mënyrën e duhur. Mungojnë tri zgjidhje të mundshme, si dhe mungon një analizë e mirëfillt e ndikimeve të mundshme, veçanërisht atyre fisakle, pasi me këtë ligj dukshëm do ketë impikime të tilla.

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për prokurorinë publike
Në vitin 2017 ka filluar procesi për VNRr dhe procedura për ndryshimin e një nga ligjet më themelore në fushën e drejtësisë – Ligji për prokurorinë publike. Me propozimin parashihej themelimi i një departamenti të veçantë në kuadër të Prokurorisë Publike për Krim të Organizuar të Republikës së Maqedonisë, i cili do të hetojë dhe do të ndjekë veprat e kryera penale, si dhe tejkalimin e kompetencave nga ana e personave me kompetenca policore. Kjo reformë është pjesë e përpjekjeve për të krijuar një sistem efektiv të kontrollit të jashtë mbi kompetencat policore. Procesi për VNRr është zhvilluar në vitin 2017 duke përfshirë këtu hartimin e projekt-ligjit dhe raportin e VNRr-së, mirëpo në vitin 2018 procedura nuk u vazhdua më tej. Hartim raporti, sa i përket përshkrimit të gjendjes, problemeve që duhet adresuar si dhe në lidhje me objektivat, është i qartë dhe i saktë. Mungojnë tri zgjidhje të mundshme, vlerësimi i ndikimeve fiskale, si dhe identifikimi i një kornize tjetër ligjore e cila duhet të përshtatet me ndryshimet e propozuara. Në lidhje me konsultat, për shkak se bëhet fjalë vetëm për një projekt- fazë, nuk mund të vlerësohet nëse procesi është apo nuk është zhvilluar si duhet.

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin e Prokurorve Publik të Republikës së Maqedonisë
Procesi për VNRr për këtë ligji filloi në vitin 2017 me publikimin e një njoftimi, por nga kërkimi në web-faqen e RVKE-së, si dhe nga të dhënat e disponueshme mund të përfundohet se procesi nuk ka vazhduar më tej.

Projekt-ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Avokatin e Popullit
Ky projekt ligjor është pjesë e iniciativës për të krijuar një sistem efikas të kontrollit të jashtëm mbi punën e personave me kompetenca policore. Procesi për VNRr ka filluar në vitin 2017 dhe, megjithëse ligji është miratuar në vitin 2018 (Gazeta Zyrtare e R.M-së 35/2018), në RVKE është botuar vetëm hartim raporti për VNRr. Raporti nuk përmban disa elmente thelbësore. Mungon përshkrimi i zgjidhjeve të mundshme si dhe vlerësimi i ndikimit rregullativ, me përjashtim të një treguesi të dobët se do të ketë ndikime fiskale. Sa i përket konsultave, janë të cekura palët e prekura si dhe mënyrat e përfshirjes së tyre. Raporti nuk përmban përshkrim të rekomandimeve që ishin, respektivisht nuk ishin marrë parasysh.

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Akademinë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë
Procedura e VNRr-së për këtë ligj ka filluar në vitin 2017 me publikimin e një njoftimi, ndërsa raportet e VNRr-së janë të botuara në vitin 2018, për këtë shkak dhe nuk janë temë e kësaj analize.

Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve
Procedura e VNRr-së për këtë ligji filloi në vitin 2017 me publikimin e një njoftimi, por nga kërkimi në web-faqen e RVKE-së, si dhe nga të dhënat e disponueshme mund të përfundohet se procedura nuk është vazhduar më tej.

2.2.4 Ministria e Punëve të Jashtme
MPJ-ja për vitin 2017 nuk ka të përpiluar Plan vjetor të VNRr-së. Gjatë vitit 2017, MPJ-ja ka dërguar në Qeverinë e R.M-së gjithsej 14 projekt-ligje, nga të cilat vetëm njëri projekt-ligj i është nënshtruar VNRr-së, ndërsa 13 projekt-ligjet e tjera paraqesin ratifikim të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe të njëjtat nuk i nënshtrohen procesit për VNRr. Të gjitha projekt-ligjet janë të miratuara nga Qeveria e R.M-së.

Ligji për masat restriktive

Nga pikëpamja formale, procedura e paraparë e VNRr-së nuk është respektuar në lidhje me publikimin e dokumenteve të mëposhtme:njoftim për fillimin e procesit të përgatitjes së projekt-ligjit, hartim raporti për VNRr dhe projekt-ligji[24]. Megjithatë, është kërkuar mendimi i palëve të prekura. Pas publikimit në RVKE dhe pas dorëzimit të raportit, MShIA përsëri tregon se raporti është i plotësuar gabimisht dhe jep udhëzime të hollësishme për plotësimin e tij[25]. Përshkrimi i gjendjes përmban vetëm përshkrim të çështjes që rregullohet me Ligjin për masat restriktive ndërkombëtare. Problemi është i elaboruar në mënyrë të qartë dhe të saktë. Objektivat janë të realizueshme dhe të matshme, mirëpo mungojnë së paku tri zgjidhje (opsione). Vlerësimi i ndikimit rregullativ është i mangët dhe i pamjaftueshëm.

2.2.5 Ministria e Financave

Për vitin 2017, Ministria e Financave ka përpiluar një Plan vjetor të VNRr-së dhe të njëjtin e ka botuar. Në Planin vjetor janë të identifikuara 12 projekte ligjore të cilat duhet t'i nënshtrohen procesit për VNRr. Në bazë të të dhënave të marra nga Sekretariati GjRVKEal i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë është konstatuar se gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2017 janë konstatuar 12 projekt-ligje të Ministrisë së Financave, pesë prej të cilave nuk i nënshtrohen procesit për VNRr. Sipas të dhënave të marra gjatë kontrollit në RVKE është konstatuar se: (1) Në RVKE janë botuar katër ligje (dy prej tyre janë botuar pasi që janë dërguar për mendim në MShIA – në kundërshtim me procedurën e VNRr-së)[26]; (2) Në MShIA janë dërguar për mendim tre hartim raporte të VNRr-së; dhe (3) Nga gjithësej shtatë ligjet e dërguara në Qeverinë e R.M-së, të cilat i nënshtrohen VNRr-së, vetëm tre prej tyre janë të shoqëruara me propozim-raportë të VNRr-së.

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kontabilitetin e buxheteve dhe përdoruesit buxhetor

Projekt-ligji dhe projekt - raporti është i botuar në RVKE pasi që është dërguar për menidim në MShIA. Ligji është miratuar nga Kuvendi i R.M –së. Ndryshimi është i vogël dhe ka të bëjë ekskluzivisht me detyrimin e përdoruesve buxhetor për ti botuar llogaritë vjetore në web - faqet e tyre brenda 15 ditëve nga dita e dorëzimit të llogarive vjetore në Regjistrin e llogarive vjetore pranë Regjistrit Qendror. Për shkak të shtrirjes së kufizuar, hartim raporti i VNRr-ës përmban informacione të pakta mbi bazën e të cilave mund të analizohet.

Ligji për ndryshimin e Ligjit për emitimin e bonove të Republikës së Maqedonisë për privatizim

Projekt-ligji dhe hartim- raporti janë botuar në RVKE pasi që është dërguar për mendim në MShIA. Ligji është miratuar nga Kuvendi i R.M –së. Me këtë ligj synohet që numri i emitimeve të bonove të privatizimit nga 15 të rritet në 18. Hartim raporti për VNRr është i mangët, por ajo që lë përshtypje është mospërmendja e implikimit fiskal - padyshim se me rritjen e numrit të emitimeve të bonove të privatizimit rrjedhimisht do të ketë implikime fiskale, madje edhe ekonomike.

24 Burimi: Opinion mbi Projekt-ligjin për masa restriktive nr. 08/32676/2, datës 21.08.2017.nga MShIA.
25 Burimi: Opinion mbi Projekt-ligjin për masa restriktive nr. 13/3082/2, datës 09.10.2017.nga MShIA.
26 Hartim raporti i VNRRr-së dhe projekt-ligji publikohen në RVKE së paku 20 ditë para se projekt – raporti të dërgohet për mendim në MShIA.

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin mbi të ardhurat personale me procedurë të shkurtuar

Me këtë ligj synohet të specifikohen, sqarohen dhe të përpunohen dispozitat e ligjit me qëllim të lehtësohet zbatimi i tyre në praktikë si dhe të zvogëlohet barra administrative. Procesi për VNRr është respektuar në aspektin formal. Në aspektin esencial, vërehet mungesa e tre zgjidhjeve të mundshme dhe në veçanti nuk kemi vlerësim të implikimeve fiskale të cilat, duke marrë parasysh se bëhet fjalë për një ligj tatimor, me shumë gjasë janë të pranishme. Sa i përket konsultave, ligji është botuar në RVKE dhe janë marrë parasysh disa komente të caktuara, ndërsa janë dhënë edhe arsyet e mos pranimit të disa komenteve të tjera.

Ligji për ndryshimin e Ligjit për qarkullimin pagesor

Me këtë ligj afati kohor në të cilin pjesëmarrësit që kanë llogari të bllokuara do të mund të bëjnë shlyerjen e ndërsjellë të detyrimeve monetare dhe përmbushjen e kërkesave nëpërmjet kompensimit, asignacionit, cedimit dhe marrjes së borxhit është vazhduar për një vit, respektivisht deri më 31.12.2018. Procesi për VNRr është respektuar nga pikëpamja formale, megjithatë mungon një analizë dhe argumentim i mirëfilltë për atë se përse është i nevojshëm vazhdimi i afatit, si dhe nuk kemi një vlerësim nëse do ketë dhe si do të jetë ndikimi i kësaj mase në aspektin ekonomik. Ligji është miratuar në vitin 2017.

Ligji për ndryshimin e Ligjit për kontributet nga sigurimi i detyrueshëm social

Ndryshimet e këtij ligji kanë të bëjnë vetëm me mënyrën e llogaritjes së principalit të personave të cilët veprimatrin bujqësore e kanë profesion të vetëm. Megjithatë, edhe këtu mungon identifikimi i ndikimeve fiskale të cilat padyshim se ekzistojnë, si dhe mungojnë konsultat me odat dhe shoqatat bujqësore, të cilat dhe janë ndër më të prekurat nga ndryshimi.

Ligji për plotësimin e Ligjit për taksat administrative

Me këtë ligji bëhet vetëm harmonizimi me Ligjin për transport rrugor në të cilin është shtuar një term i ri "vazhdimi i licencës". Me këtë ligj, për shkak të nevojës, bëhet edhe rregullimi i taksave. Megjithatë, edhe këtu mungon identifikimi i ndikimeve fiskale të cilat padyshim se janë të pranishme, si dhe mugnojnë konsultat me transportuesit, të cilët janë të prekur nga ky ndryshim.

Ligji për rezervat e naftës

Me këtë ligj vetëm prolongohet zbatimi i ligjit bazik, për këtë arsye dhe nuk është bërë analizë e detajuar e raportit të VNRr-së. Megjithatë, nuk janë paraqitur arsye të mjaftueshme dhe të justifikueshme për prolongimin e zbatimit.

Ligji për paraqitjen dhe evidentimin e detyrimeve

Këtu kemi një përshkrim të qartë të gjendjes dhe të shkaqeve të problemeve. Objektivat janë të realizueshme dhe të matshme. Mungojnë tri zgjidhje të mundshme. Sipas raportit, ligji nuk do të ketë ndikime fiskale, ndërsa është paraparë edhe një zgjidhje softuerike për paraqitjen dhe evidentimin e detyrimeve, si dhe janë paraparë shpenzimet për trajnimin e stafit i cili do të punojë me këtë softuer. Megjithatë, edhe këtu mungon identifikimi i ndikimeve fiskale të cilat padyshim se janë të pranishme, si dhe mugnojnë konsultat me transportuesit, të cilët janë të prekur nga ky ndryshim.

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për lojërat e fatit dhe lojërat argëtuese

Ky projekt-ligj, mes tjerash, parasheh dhënien e licencës për çdo lokal afarist në të cilin organizohen lojërat e fatit në automate, gjë e cila do të ketë ndikim pozitiv në të ardhurat e buxhetit të Republikës së Maqedonisë, si dhe në kufizimin e numrit të pikave pagesore që mund të hapen me një licencë për bastore. Edhe pse është respektuar procesi për VNRr, përsëri ka të meta serioze. Në pjesën ku duhet të identifikohet ndikimi rregullativ (pavarësisht se a është pozitiv apo negativ), mungon një analizë e beneficioneve fiskale të këtij ligji, që është edhe një ndër te metat kryesore.

2.2.6 Ministria e Ekonomisë

Ministria e Ekonimisë për vitin 2017 nuk ka përpiluar dhe botuar Plan vjetor të VNRr-së. Megjithatë, nga kërkimi në RVKE mund të përfundohet se në po atë viti ka filluar procesi për VNRr për gjithësej 18 ligje. Në asnjërin nga proceset e filluara të VNRr-së gjatë vitit 2017, nuk është konstatuar projekt – ligj nga ana e Qeverisë së R.M –së.

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike

Procesi për VNRr për këtë ligj filloi me një njoftim të botuar më 3 nëntor të vitit 2017. Projekt-ligji si dhe hartim raporti janë botuar me 21.11.2017. Procesi ka vazhduar edhe në vitin 2018. Në hartim raportin, përshkrimi i gjendjes përmban vetëm përshkrimi të rregullimit ligjor të çështjes, ndërsa sa i përket problemeve, ato janë të identifikuara në mënyrë të qartë dhe të saktë. Objektivat janë të realizueshme dhe të matshme. Mungojnë tri zgjidhje të mundshme. Vlërësimi i ndikimit është i kënaqshëm. Procesi konsultativ është zhvilluar në mënyrën e duhur.

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shoqëritë tregtare

Procesi për VNRr ka filluar më 03.11.2017. Në RVKE është botuar vetëm projekt-ligji dhe hartim raporti për VNRr. Nga ana e ME-së na është dërguar projekt-ligji i hartuar në dhjetor të vitit 2017, por i cili nuk është botuar në RVKE. Ndryshimi i propozuar ka të bëjë ekskluzivisht me njohjen e certifikatës për zotërimin e gjuhës angleze "APTIS", si dëshmi për zotërimin e gjuhës, si dhe heqjen e testit psikologjik dhe testit të integritetit për disa funksione të caktuara. Mungojnë tri zgjidhje të mundshme, ndërsa vlerësimi i ndikimit të rregullativës është i kënaqshëm. Procesi i konsultave është zhvilluar vetëm me organet shtetërore.

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për standardizim, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për akreditim, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për metrologjinë, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për inspektimin teknik, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pronësinë industriale, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Entin gjeologjik të Republikës së Maqedonisë, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për themelimin e Agjencisë për mbështetje të sipërmarrjes në Republikën e Maqedonisë, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për themelimin e Agjencisë për energji të Republikës së Maqedonisë

Proceset e VNRr-së për këto nëntë ligje janë analizuar bashkërisht për arsye se të gjitha këto ligje kanë shtrirje identike dhe të kufizuar, siç është njohja e certifikatës "APTIS", si dëshmi për zotërimin e gjuhës angleze, si dhe heqja e testit psikologjik dhe testit të integritetit. Procesi për VNRr për të gjitha këto ligje ka filluar më 10 nëntor të vitit 2017. Me 21.11.2017, edhe pse këto projekt-ligje janë të miratuar nga Kuvendi i R.M-së në vitin 2018, janë botuar vetëm projekt-ligjet dhe hartim raportet e VNRr-së. Ajo që është e përbashkët për të gjitha këto hartim raporte të VNRr-së është se ato përmbajnë vetëm informacione bazike, si dhe mungon një analizë më e detajuar.

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Inspektoratin shtetëror të trigut

Me këtë propozim, përveç njohjes së certifikatës "APTIS" dhe heqjes së testit psikologjik dhe testit të integritetit, bëhet dhe transferimi i kompetencave për shqyrtimin e kundërvajtjeve nga Inspektorati në Ministrinë. Nga pikëpamja formale, procesi për VNRr është zhvilluar në mënyrën e duhur. Megjithatë, ashtu si edhe tek ligjet tjera, hartim raporti nuk është mjaft i detajuar.

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për sigurinë e produkteve, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kontrollin e punimeve nga metalet e çmuara, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve

Proceset e VNRr-së për këto tri ligje janë analizuar bashkërisht për arsye se kanë shtrirje identike dhe të kufizuar siç është harmonizimi i ndryshimit për transferimin e kompetencave për shqyrtimin e kundërvajtjeve, nga IShT-ja në Ministrinë e Ekonomisë. Raportet janë pothuajse identikë. Mungojnë tri zgjidhje të mundshme, si dhe një vlerësim i ndikimit rregullativ. Konsultat janë zhvilluar vetëm me organet shtetërore.

Ligji për energjetikë

Për vitin 2017, hartimi i Ligjit për energjetikë është një ndër projekt-ligjet më voluminoz dhe më kompleks në kuadër të të gjitha ministrive. Si i tillë, duke marrë parasysh rëndësinë që ka ky ligj, si për ekonominë, ashtu edhe për standardin jetësor të amvisërive dhe për mjedisin jetësor, një procedurë e duhur dhe e rregullt e VNRr-së ishte e rëndësisë së veçantë. Nga kërkimi në hartim raportin dhe propozim-raportin e VNRr-së mund të kostatohet se, për dallim nga projektet tjera ligjore, i është kushtuar kohë dhe vëmendje të vaçantë përgatitjes së tyre. Përshkrimi i gjendjes, problemeve dhe i synimeve që duhet të arrihen është i qartë dhe i saktë. Sa i përket ndikimit të rregullativës, edhe pse janë të përshkruara të gjitha llojet e ndryshme të ndikimit (ekonomikë, fiskal, etj.), megjithatë mungojnë analizat, si dukumente të posaçme mbi bazën e të cilave jepet vlerësimi i ndikimit. Në lidhje me përfshirjen e palëve të prekura, ky ligj cilësohet si më i avancuar, përshkak se janë zhvilluar konsulta me më shumë palë të prekura, si dhe është botuar një pasqyrë e detajuar e të gjitha propozimeve dhe komenteve me sqarim nëse janë të pranuara apo jo. Në përgjithësi, me përjashtim të mungesës së analizave si dokumente të posaçme, VNRr-ja për këtë ligj i plotëson kushtet e përcaktuara me Udhëzimin dhe Metodologjinë.

Ligji për shërbime

Ky projekt ligjor është i dyti për nga volumi dhe kompleksiteti, pas Ligjit për energjetikë. Me këtë ligj synohet transpozimi i Direktivës së BE-së për Shërbime. Procedura e VNRr-së për këtë ligj ka filluar në fund të vitit 2017 dhe deri më sot procedura ka ngelur në fazën e projekt-rapotit të VNRr-së. Nga kërkimi në hartim raportin e VNRr-së mund të përfundohet se përshkrimi i gjendjes është i plotë dhe i saktë, ndërsa sa i përket shkaqeve të problemit, ato nuk janë mjaft të elaboruara. Nuk kemi një formulim të duhur të objektivit, i cili duhet të jetë i shkurtër, i saktë, i matshëm dhe i realizueshëm. Edhe në këtë rast, mungon zgjidhja e tretë e mundshme. Në lidhje me vlerësimin e ndikimit të rregullativës, nuk kemi analiza konkrete të kostove dhe përfitimeve, si dhe analiza të impaktit fiskal. Përveç kësaj, nuk është cekur asnjë burim në bazë të cilit janë dhënë vlerësimet e ndikimit. Sa i përket konsultave, kemi një proces të kënaqshëm ku ishin të përfshira të gjitha palët e prekura. Raporti përmban edhe arsyetime të argumentuara se përse nuk janë marrë parasysh disa propozime të caktuara.

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për produktet e ndërtimit

Ky ligj paraqet një përpjekje për harmonizimin e Ligjit me Rregulloren e BE-së 305/2011. Në aspektin formal, procedura e VNRr-së është zhvilluar si duhet, mirëpo raporti për VNRr (projekt) është shumë i mangët për t'u analizuar në hollësi. Ajo që vihet re edhe këtu është mungesa e analizave në bazë të së cilave do të përcaktoheshin ndikimet ekonomike dhe ato fiskale të ligjit. Me këtë ligj rregullohen kushtet për hedhjen e produkteve të ndërtimit në treg, ashtuqë ndikimi ekonomik, si tek prodhuesit ashtu edhe tek konsumatorët e këtyre produkteve do të jetë i pashmangshëm. Mungon një përshkrim i mënyrës së zhvillimit të kosnultave me palët e prekura.

2.2.7 Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Administrimit të Ujrave

Sipas Planit vjetor të VNRr-së për vitin 2017, i botuar në RVKE, MBPAU-ja kishte planifikuar të zhvillojë procese të VNRr-së për gjithësej 20 ligje, mirëpo nga ana e Qeverisë është konstatuar se nga kjo ministri është dërguar vetëm një projekt-ligj. Gjatë hartimit të këtij ligji, konstatuar në seancën e Qeverisë së R.M-së e mbajtur më 13. 06. 2017, procedura e VNRr-së nuk është respektuar plotësisht në aspektin formal (ligji nuk është i botuar në RVKE, si dhe hartim raporti për VNRr për proejkt-ligjin nuk është dërguar për mendim në MShIA).

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Agjencinë për nxitjen e zhvillimit bujqësor, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shëndetin e bimëve, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Inspektoratin shtetëror të bujqësisë, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për inspektimin e pyjeve dhe gjuetisë

Me këto ligje bëhet ndërhyrje në kushtet e parapara me ligj të cilat duhet t'i plotësojnë bartësit e funksioneve publike. Me këto ndryshime hiqet testi psikologjik dhe prolongohet zbatimi i kushtit për zotërimin e gjuhës angleze, si dhe obligimi i drejtorit të emërurar për të plotësuar kushtin për njohjen e gjuhës së huaj brenda një viti nga dita e emërimit të tij. Hartim raportet e proceseve të VNRr-së nuk janë të botuara. Sa i takon procesit të konsultave, hartim raportet janë mjaftë të mangëta.

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pyjet

Me këtë ligj, MBPAU-ja kishte për qëllim thjeshtësimin e procedurës dhe dokumentacionit për leje për prerjen e drunjëve. Procedura e VNRr-së ka filluar në vitin 2017 duke botuar një njoftim në RVKE, mirëpo aty dhe ka ngecur dhe nuk janë ndërmarrë aktivitete të tjera.

Ligji për shfuqizimin e Ligjit për shtijen e tokës bujqësore në pronësi shtetërore

Me këtë zgjidhje ligjore, MBPAU-jakishte për qëllim shfuqizimi e dispozitave të Ligjit për shitjen e tokës bujqësore në pronësi shtetërore, të cilat u treguan si të pazbatueshme në praktikë. Procedura e VNRr-së ka filluar në vitin 2017 duke botuar një njoftim në RVKE, mirëpo aty dhe ka ngecur dhe nuk janë ndërmarrë aktivitete të tjera.

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për sigurinë e ushqimeve

Me miratimin e këtij ligji, MBPAU-ja kishte për qëllim rregullimin e pohimeve nutricioniste dhe atyre ligjore që kanë të bëjnë me rritjen, zhvillimin dhe shëndetin e fëmijëve, shtojcat ushqimore për nevoja të veçanta nutricioniste, ushqimin e fortifikuar dhe ushqimin e sportistëve. Procedura e VNRr-së ka filluar në vitin 2017 duke botuar një njoftim në RVKE, mirëpo aty dhe ka ngecur dhe nuk janë ndërmarrë aktivitete të tjera.

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjueti, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për peshkim dhe akuakulturë

Këto dy ligje kanë për qëllim thjeshtësimin e procedurës së testimit për gjahtarë dhe peshkatarë. Në RVKE janë të botuara vetëm hartim raportet, mirëpo, edhe pse ligji është miratuar në vitin 2018, nuk kemi asnjë propozim-raport. Hartim raportet, me përjashtim të tri zgjidhjeve të mundshme, i përmbajnë të gjitha elementet e nevojshme.

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për materialin faror dhe mbjellës të bimëve bujqësore
Sipas asaj që është botuar në RVKE, procesi për VNRr për këtë ligj ka filluar në vitin 2017 dhe ka vazhduar deri në fazën e projekt-ligjit/raportit. Edhe pse ligji është miratuar në vitin 2018, megjithatë nuk kemi propozim-raport të botuar në RVKE. Nga kërkimi e hartim raportit mund të përfundohet se përshkirmi i gjendjes është realativisht i mangët për nga analizat dhe të dhënat në lidhje me nevojën për miratimin e këtij ligji. Raporti nuk përmban tri zgjidhje të mundshme, ndërsa mungon edhe një analizë e saktë e ndikimit të këtij ligji, veçanërisht në lidhje me mjedisin jetësor. Gjithashtu, mungon një pasqyrë e procesit të konsultave, si dhe mendimeve dhe komenteve të pranuara.

Ligji për duhanin, produkte të duhanit dhe produkte të ngjashme
Procesi për VNRr ka filluar në vitin 2017, por në thelb u zhvillua në vitin 2018 dhe për këtë arsye nuk u mor në konsideratë gjatë kësaj analize.

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për konsolidimin e tokës bujqësore
Sipas asaj që është botuar në RVKE, procesi për VNRr për këtë ligj ka filluar në vitin 2017 dhe ka vazhduar deri në fazën e projekt-ligjit/raportit. Edhe pse ligji është miratuar në vitin 2018, nuk kemi një propozim-raport të botuar në RVKE. Nga kërkimi i hartim raportit mund të përfundohet se gjendja, problemet dhe synimet janë të përshkruara tërësisht në mënyrën e duhur. Mungojnë tri zgjidhje të mundshme, si dhe një analizë e thellë e ndikimit rregullativ. Raporti nuk përmban informacione në lidhje me procesin konsultativ.

2.2.8 Ministria e Shëndetësisë
Ministria e shëndetësisë në Planin vjetor të VNRr-së për vitin 2017 kishte paraparë vetëm një ligj i cili duhet t'i nënshtrohet procesit për VNRr, ndërsa nga ana e Qeverisë janë miratuar dy projekt-ligje[27] të Ministrisë së Shëndetësisë të cilat nuk janë të botuara në RVKE dhe, gjithashtu, hartim raportet e VNRr-së për projekt-ligjet nuk janë dërguar për mendim në MShIA. Në QRM vetëm njëri nga propozime-ligjet është dërguar i shoqëruar me propozim-raport të VNRr-së.

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kujdesin shëndetësor
Në vitin 2017, Ministria e Shëndetësisë proces të VNRr-së ka zhvilluar vetëm për këtë ligj, ndërsa të gjitha dokumentet kryesore janë të botuara në RVKE. Në hartim raportin e VNRr-së përshkrimi i gjendjes dhe analiza e problemeve është bërë në mëny rë të detajuar, si dhe raporti përmban objektiva të matshme dhe të realizueshme. Edhe pse mungojnë tri zgjidhje të mundshme, raporti përmban një analizë mjaft të detajuar të ndikimit rregullativ. Në lidhje me procesin konsultativ, i njëjti është zvhilluar në mënyrën e duhur, ndërsa raporti përfshin edhe një pasqyrë të mendimeve të marra dhe të inkorporuara, si dhe të atyre që nuk janë marrë parasysh duke arsyetuar mos inkorporimin e tyre.

2.2.9 Ministria e Arsimit dhe Shkencës
MASh për vitin 2017 ka botuar Plan vjetor të VNRr-së dhe aty thuhet se do të sillen gjashtë ligje. Nga proceset e planifikuara, VNRr-ja ka filluar vetëm për Ligjin për arsimin e lartë, Ligjin për arsimin fillor dhe Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për arsimin e mesëm. Sa i përket ligjeve tjera, edhe pse është planifikuar, procesi për VNRr nuk është zhvilluar. Nga ana tjetër, ka filluar procesi për VNRr për Ligjin për gjimnazin matematikor dhe Ligjin për librat shkollorë për arsimin fillor dhe të mesëm[28]. Megjithatë, asnjë nga këto ligje nuk janë miratuar si projekt-ligje nga ana e Qeverisë së R.M, gjegjësisht, edhe pse procesi për VNRr ka filluar në vitin 2017, i njëjti ka qenë në fazën e hartim raportit, deri më 31.12.2017.

27 Propozim-ligji për ndryshimin e Ligjit për studimet e mjekësisë dhe përsosjes së vazhdueshme profesionale, me procedurë të shkurtuar, dhe propozim-ligji për ndryshimin e Ligjit për sigurimin shëndetësore, me procedurë të shkurtuar.
28 Burimi: Informacion nga MASh 03-5130/ 2, i datës 25.04.2018.

Ligji për arsimin e lartë
Mos publikimi i hartim-raportit të VNRr-së, si dhe mos plotësimi në masë të madhe i hartim raportit për këtë ligj, me të cilin rregullohet materie komplekse dhe voluminoze, nuk len hapësirë për analizë të përmbajtjes.

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për librat shkollorë për arsimin fillor dhe të mesëm
Hartim raporti i botuar në RVKE është i mangët. Gjatë përshkrimit të gjendjes bëhet përshkrim i projekt-ligjit dhe jo i rrethanave që kërkojnë një rregullativë të re dhe as i problemeve që duhet të adresohen. Mungojnë objektivat e rregullativës, dhe nuk kemi tri zgjidhje të mundshme (nuk ka përshkrim të status kuos). Sipas raportit, propozimi nuk do të ketë ndikim (ekonomik, fiskal etj), që është e palogjikshme duke marrë parasysh atë që është e planifukuar të realizohet, ndërsa mungon dhe një përshkrim i mënyrës së përfshirjes së palëve të prekur.

Ligji për gjimnazin matematikor
Hartim raporti përmban një analizë të gjerë dhe të hollësishme të gjendjes dhe shkaqeve, kështuqë mund të vlerësohet se egziston nevoja për një ligj të këtillë. Objektivat e rregullativës nuk janë të formuluara në mënyrë precize që ato të mund të jenë të matshme, ndërsa mungojnë dhe propozimet e tri zgjidhje të mundshme. Raporti nuk përmban vlerësim të ndikimit rregullativ. Është e palogjikshme se me formimin e një institucioni të veçantë arsimor, gjimanzi matematik-informartik, nuk do të ketë ndikime ekonomike apo fiskale si dhe shpenzime për zbatimin e rregullativës. Mungon përshkrimi i mënyrës së përfshirjes së palëve të prekura.

2.2.10 Ministria e Punës dhe Politikës Sociale
MPPS nuk ka botuar Planin Vjetor për VNRr për vitin 2017 në RVKE, edhe pse gjatë vitit VNRr ka filluar proceset për pesë ligje dhe 10 projekt-ligje janë themeluar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë (për disa prej tyre, proceset e VNRr-së kanë filluar më herët). MPPS gjatë vitit 2017 filloi proceset e VNRr-së për ligjet në vijim:

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtje sociale
Procesi i VNRr-së për këtë ligj u zbatua në verën e vitit 2017, kur ligji u miratua. Vetëm një hartim raport u publikua në RVKE, ndërsa hartim raporti u dërgua në Qeveri dhe me vonesë në MShIA. Hartimi i raportit është i pakët me të dhëna. Situata dhe problemet nuk janë përshkruar mjaftueshëm dhe në mënyrë të saktë. Ekzistojnë tri zgjidhje të mundshme, si dhe analiza lidhur me ndikimin e rregullores. Ajo që është pozitive është se raporti përmban një vlerësim të implikimeve fiskale, por pa një përshkrim se si është arritur kjo shumë. Sa i përket konsultimeve, raporti është i pakët.

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për paga minimale në Republikën e Maqedonisë
Ndryshimet e parashikuara në këtë ligj ishin pjesë e programit të punës së Qeverisë. Ligji rrit pagën minimale për të gjithë punonjësit dhe rregullon ndihmën financiare për punëdhënësit në mënyrë që të ushtrojë të drejtën për një pagë minimale. Lidhur me procedurën e VNRr-së, mungon botimi i hartim raportit të VNRr-së në RVKE, dhe hartim raporti është dërguar në MShIA pas miratimit nga ana e Qeverisë, në kundërshtim me RVKE. Sa i përket përmbajtjes së raportit të VNRr-së, mungojnë të dhëna në përshkrimin e situatës, nga e cila rezulton nevoja për të rritur pagën minimale (të dhënat demografike, standardi i jetesës, punësimi etj.). Prandaj, shkaqet e problemeve nuk janë identifikuar siç duhet. Nuk ekzistojnë tri zgjidhje të mundshme, dhe analiza e ndikimit është gjithashtu e pakët, edhe pse përmban një vlerësim të implikimeve fiskale. Hartimi i raportit nuk mund të konkludojë se është kryer një procedurë e përshtatshme konsultimi.

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për sigurim pensional të detyrueshëm kapital, Ligji për ndryshimin e Ligjit për inspektimin e punës
Këto dy ligje harmonizojnë projekt-ligjin për ndryshimin e Ligjit për zyrtarët administrativ dhe shtojnë APTIS-in si një nga provimet për aftësimin e gjuhës angleze dhe gjithashtu heq kushtin për marrjen e testit psikologjik dhe testit për integritet. Hartim raportet përmbajnë elementet e nevojshme, duke pasur parasysh se nuk bëhet fjalë për ligje të gjera.

Ligji për agjencitë private të punësimit
Ky ligj u propozua me qëllim të krijimit të një kornize të vetme ligjore që do të rregullonte punën e agjencive private të punësimit, që përndryshe i nënshtrohet rregullimit të disa ligjeve të ndryshme. Hartim raporti i VNRr-së është i pakët në lidhje me përshkrimin e situatës dhe arsyet pse është e nevojshme të miratohet ky ligj. Arsyetimi i përgjithshëm është në drejtim të barazimit të kornizës ligjore, por nuk ka përshkrim të problemeve që lindin në praktikë për shkak të kornizës ligjore të pabarabartë ose të dyfishtë. Vlerësimi i ndikimit të rregullores është veçanërisht i pakët. Është zbatuar një proces konsultativ dhe MPPS jep përgjigje për propozimet dhe komentet e mbledhura.

2.2.11 Ministria e Vetëqeverisjes lokale
MVL në vitin 2017 nuk ka përgatitur një Plan vjetor për VNRr. Në vitin 2017, sipas planeve, MVL nuk kishte iniciativa legjislative[29], prandaj nuk u zbatuan procese të VNRr-së.

2.2.12 Ministria e Kulturës
Ministria e Kulturës nuk ka miratuar dhe botuar një Plan Vjetor për VNRr në vitin 2017[30]. Sipas të dhënave të marra gjatë kërkimit në RVKE, u konstatua se të gjitha ligjet janë botuar në RVKE. Sipas opinionit të MShIA, janë paraqitur 3 raporte të VNRr-së, por në të njëjtën datë kur janë botuar në RVKE - në kundërshtim me procedurën e VNRr-së dhe nga gjithsej 6 projekt-ligje të paraqitura në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, vetëm 3 përmbajnë një hartim raport për VNRr.

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kulturë (1), Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kulturë (2)
Lidhur me këtë ligj, janë zbatuar dy ndryshime gjatë vitit 2017, në periudhë prej disa muajsh, që ngre çështjen e mungesës së planifikimit të duhur, kur është e sigurt se duhet të bëhen ndërhyrje të njëpasnjëshme në disa fusha të ligjit. Hartimi raportet mbi dy ligjet përmbajnë përshkrim të detajuar dhe mjaftueshëm të përpunuar të shkaqeve, të problemeve dhe objektivave e projekt-rregullores, por mungojnë tri zgjidhjet e mundshme. Nga rregullorja, impaktet pozitive dhe negative u identifikuan në thelb. Konsultimet u zhvilluan përmes publikimit të RVKE dhe mbledhjes së opinioneve nga palët e prekura. Palët e prekura përfshijnë vetëm autoritetet shtetërore. Është raportuar se artistët e shquar janë konsultuar, por pikëpamjet dhe opinionet e tyre nuk janë deklaruar.

Ligji për ndërprerjen e vlefshmërisë së Ligjit për Artistin Kombëtar të Republikës së Maqedonisë, Ligji për ndërprerjen e vlefshmërisë së Ligjit për përkrahjen e prodhimit të brendshëm të muzikës
Është e qartë nga titulli që me këto ligje pushojnë së zbatuarat ligjet bazë. Nevojat për miratimin e këtyre ligjeve janë të detajuara dhe të shpjeguara mjaftueshëm në hartimin e raportit të VNRr-së: nuk ka tri zgjidhje të mundshme. Ndikimet e mundshme pozitive dhe negative janë identifikuar në thelb. Konsultimet u zhvilluan përmes publikimit në RVKE dhe mbledhjes së opinioneve nga palët e prekura. Palët e interesuara përfshijnë vetëm organet shtetërore, por jo edhe entitete të tjera jo shtetërore.

29 Informacioni nga MVL, nr. 18-877/2 од 11.5.2018

30 Informacioni nga MK, nr. УП1 52-162 од 1.6.2018

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për përdorimin e gjuhës maqedonase
Ky ligj rregullon disa çështje që lidhen me kryerjen e veprimtarisë së lekturës. Procesi i VNRr-së zbatohet në përputhje me Udhëzuesin, por ajo që mungon është një përshkrim nëse dhe në çfarë mënyre janë kryer konsultimet me rrethin profesional lidhur me ndryshimet, lektorët dhe shoqatat e tyre.

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi veprimtarinë filmike, Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore
Fusha e ndërhyrjes në këto dy ligje është identike dhe e kufizuar në rregullimin e kushteve të përcaktuara nga këto ligje, të cilat duhet të përmbushen nga mbajtësit e funksioneve publike. Procesi i VNRr-së është zbatuar në mënyrë të përshtatshme, por mungojnë tri zgjidhje të mundshme për problemin. Janë kryer konsultime përmes publikimit në RVKE dhe mbledhjen e opinioneve nga palët e interesuara. Palët e interesuara përfshijnë vetëm organet shtetërore, jo entitetet e tjera jo shtetërore.

2.2.13 Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës
MShIA nuk ka botuar Planin Vjetor për VNRr për vitin 2017, megjithëse në të njëjtën periudhë është nisur një proces për VNRR për dhjetë ligje dhe Qeveria ka themeluar nëntë projekt-ligje nga kjo ministri.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për nëpunësit administrativ, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për themelimin e Komisionit Shtetëror për procedurat administrative dhe punësimit në shkallë të dytë, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Inspektimit Administrativ, Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për material arkivor, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për themelimin e Komisionit shtetëror për vendosje në shkallë të dytë në fushën e procedurave të inspektimit dhe procedurës kundërvajtëse, Ligji për ndryshimin e Ligjit për themelimin e një rrjeti akademik të kërkimit në Maqedoni
Me këto gjashtë ligje, bëhet një ndryshim në kushtet për përzgjedhje të bartësve të funksioneve publike, ku certifikata APTIS shtohet si dëshmi e pranueshme e aftësive të gjuhës angleze, por hiqet kërkesa për testimin psikologjik. Hartim raportet për VNRr për këto ligje janë publikuan në RVKE, por jo edhe hartim raportet. Për shkak të fushëveprimit të ngushtë të ndryshimeve, hartim raportet plotësojnë kriteret e përcaktuara në Udhëzues.

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për komunikimet elektronike
Ky ligj rrjedh nga rekomandimet e grupit të ekspertëve të lartë për çështjet sistematike nga sundimi i drejtësisë lidhur me monitorimin e komunikimeve. Ligji u miratua nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, por nuk u publikua një hartim raport për VNRr. Hartimi raporti përmban një përshkrim të plotë dhe të saktë të situatës, problemeve dhe objektivave, por mungjnë tri zgjidhje të mundshme. Vlerësimi i ndikimit të rregullores nuk mbështetet nga analiza të caktuara, ndërsa në aspektin e konsultimeve, nuk mund të nxirret një konkluzion, pasi që është një hartim raport. Në RVKE nuk ka përgjigje për komentet dhe sugjerimet e nënshtruara.

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për themelimin e ndërmarrjes publike Radiodifuzioni i Maqedonisë
Ky ligj harmonizon dispozitat e ligjit bazë me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për shërbimet e medias audio dhe audiovizuele. Si një ligj që synon harmonizimin me një ligj tjetër, fusha endryshimit është e kufizuar. Hartim raporti është plotësuar në mënyrë të përshtatshme sa i përket përshkrimit të situatës, problemeve dhe objektivave, ndërsa në pjesën tjetër është i pakët.

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhim elektronik
Qëllimi i këtij ligji është standardizimi i përmbajtjes së dokumenteve që qytetarët do të marrin në formë elektronike dhe krijimi e një bazë të dhënash elektronike të integruar të organeve që komunikojnë me njëri-tjetrin. Procesi për VNRr, përveç se nuk është botuar një hartim raport në RVKE, plotëson kushtet themelore, por ka mungesë e një analize të thellë të ndikimit, veçanërisht në aspektin e kostos së zbatimit, të cilat janë të pashmangshme për një ligj me lëndë të tillë, pavarësisht nëse është çështje e disa zgjidhjeve softuerike dhe platformave përmes të cilave do të kryhet menaxhimi elektronik.

Ligji për ndryshimin e Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele
Ky ligj është një nga projektet më të gjera që MShIA ka punuar gjatë vitit 2017. Arsyet për ndryshimin lindin nga nevoja për departizimin dhe profesionalizimin e shërbimit të radiodifuzionit publik dhe të organit rregullator - Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele. Ky ndryshim ende nuk është futur në procedurën parlamentare. Hartim raporti për VNRr përmban një analizë të detajuar të arsyeve për miratimin e këtij ligji, si dhe të procesit të hapur konsultativ të zhvilluar dhe mendimet dhe sugjerimet e marra.

2.2.14 Ministria e Transportit dhe Lidhjeve
Ministria e Transportit dhe Lidhjeve nuk ka botuar Planin Vjetor për VNRr në 2017 dhe këtë vit Qeveria miratoi vetëm një projekt-ligj nga kjo ministri - Ligji për shitjen dhe dhënien me qira të ndërtesave dhe objekteve afariste të Republikës së Maqedonisë, i cili është paraqitur pa u botuar më parë në RVKE. Në vitin 2017, MTV nisi një proces të VNRr për tri projekt ligje.

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për realizimin e projekteve infrastrukturore për ndërtimin e rrugës Milladinovci-Shtip dhe pjesa e rrugës Kërçovë-Ohër
Ky ligj lejon zgjatjen e afatit për ndërtimin e rrugës së planifikuar Miladinovci - Shtip. Edhe pse me një subjekt shumë të kufizuar të amendamentit, është e nevojshme të analizohet procesi për VNRr për këtë ligj, në mënyrë që të përcaktohet nëse VNRr për ligjet që kanë të bëjnë me projektet e infrastrukturës në mënyrë të përshtatshme vlerëson ndikimin e rregullores. Duke pasur parasysh se afati i planifikuar për përfundimin e ndërtimit vazhdohet për së dyti, është e pritshme që vazhdimi të ketë ndikim financiar, megjithatë, sipas hartim raportit të botuar, projekt-ligji nuk ka ndikime fiskale.

Ligji për ndryshimin e Ligjit për trajtimin e objekteve të ndërtuara pa leje
Projekt-ligji vetëm shtyn afatin për dorëzimin e kërkesave për "legalizimin" e ndërtimeve të paligjshme. Hartimi i raportit për VNRr është shumë i pakët dhe nuk ka informacion për një proces konsultimi.

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për transportin e mallrave të rrezikshme në trafikun rrugor dhe hekurudhor
Ky ligj, ashtu si ato të mëparshmet, përmban një ndryshim shumë të kufizuar në tekstin themelor të ligjit. Procesi i VNRr formalisht plotëson kushtet e përshkruara.

2.2.15 Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor
Sipas Planit Vjetor për VNRr për vitin 2017, i botuar në RVKE, është planifikuar vetëm një ligj, ndërsa Qeveria e Republikës së Maqedonisë nuk ofron projekt-ligje nga kjo ministri. Në 2017, filluan katër procedura për VNRr.

Projekt-ligji për inspektimin mjedisor
Arsyeja kryesore për përgatitjen e një ligji të ri është nevoja për planifikimin e koordinuar shumëvjeçar të inspektimit në nivel qendror dhe lokal. Hartim raporti për VNRr tregon një proces të duhur dhe tërësisht të zbatuar të VNRr-së. Raporti në mënyrë të qartë dhe koncize jep një përshkrim të situatës dhe arsyet për miratimin e këtij ligji. Raporti ofron disa zgjidhje për problemin, duke analizuar në thellësi ndikimet e secilës prej zgjidhjeve. Konsultimet substanciale janë kryer aty ku ministria ka deklaruar për të gjitha propozimet dhe komentet e pranuara.

Ligji për menaxhimin e mbeturinave, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e natyrës, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mjedisin
Procedura për VNRr për këto ligje filloi në vitin 2017 me publikimin e një njoftimi, por një hartim raport nuk është botuar dhe prandaj nuk i nënshtrohet analizës.

2.3 Problemet dhe sfidat në zbatimin e procesit të VNRr-së - pamje nga brenda
Me qëllim të identifikimit të kapaciteteve të ministrive për zbatimin e procesit të VNRR, u krye një sondazh duke përdorur një mjet të mbledhjes së të dhënave në internet. Pyetësori për zbatimin e procesit të VNRr-së në kuadër të ministrive në Republikën e Maqedonisë ishte paraparë të plotësoheshin nga personat përgjegjës për zbatimin e procesit të VNRr-së në ministrinë përkatëse. Nga 15 ministritë e linjës, të cilave u dërgua pyetësori, u morën përgjigje nga nëntë ministri[31].

Koordinatorët për VNRr nuk janë në të gjitha ministritë e të njëjtës kategori, nivel dhe titull pune. Në disa nga ministritë ata janë zyrtarë të lartë, dhe në disa janë punonjës administrativë në kategorinë B ose C. Por ajo që është e përbashkët është se mbi 90 përqind nga tyre kanë diplomë universitare dhe kanë diplomuar në Fakultetin e drejtësisë. Një nga të anketuarit ka diplomë universitare, por ka diplomuar në Fakultetin ekonomik.

Më shumë se 90 për qind e koordinatorëve të procesit të VNRr-së të caktuar në ministritë kanë një zëvendës. Vetëm 50 për qind e koordinatorëve dhe zëvendësit e tyre kanë marrë pjesë në trajnimin për VNRr, dhe vetëm një prej tyre vuri në dukje se ka marrë pjesë në mbi 20 trajnime. Pjesa tjetër e të anketuarve kanë vizituar një deri tri trajnime, dhe kjo më së shumti kryhet nga MShIA. Trajnimet kanë përfshirë tema të tilla si RVKE, përdorimi i të dhënave nga Regjistri Qendror në përgatitjen e raporteve procesit për VNRr dhe mjetet që përdoren në të, etj. Të anketuarit argumentojnë se trajnimi ka ndihmuar në masë të madhe dhe ka kontribuar në të kuptuarit më të madh të procesit të VNRr.

Është e rëndësishme të theksohet se të anketuarit konsiderojnë se duhet të ketë një edukim të vazhdueshëm në lidhje me VNRr. Trajnimet duhet të jenë të detyrueshme dhe duhet të ketë më shumë persona për të marrë pjesë në to. Temat për të cilat mund të organizohen trajnime janë në drejtim të përcaktimit të problemeve, analiza e rreziqeve dhe pasojat financiare të zbatimit të një politike publike, siç argumentojnë të anketuarit.

Është shqetësuese që të anketuarit kanë deklaruar se analizat që duhet të zhvillohet gjatë VNRr-së shpesh nuk zbatohen. Në fund të fundit, mbi 50 për qind thonë se analiza e kostove dhe përfitimeve, analiza e kostos dhe efikasitetit, analiza multikriteriumike, analiza e rreziqeve dhe modeli i kostove standarde në analizimin e zgjidhjeve/opsioneve të mundshme me të cilat mund të arrihen qëllimet zakonisht nuk janë duke u zbatuar. Analizat që janë duke u bërë, bëhen nga punonjësit e ministrisë. Në një numër të vogël rastesh, ato bëhen nga ekspertë të jashtëm dhe të pavarur.

31 Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Transportit dhe Lidhjeve, Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale

Në shumicën e pyetësorëve është treguar se ka mënyra të ndryshme për të përfshirë palët e interesuara në procesin e VNRr-së, por ajo që nuk mund të përcaktohet është se sa nga komentet, mendimet, sugjerimet dhe rekomandimet e tyre janë pranuar. Përndryshe, palët e prekura mund të kyçen në grupet punuese për përgatitjen e një zgjidhje të re ligjore, mund të marrin pjesë në takime, të paraqesin kërkesa me shkrim dhe mendime, të bëjnë komente mbi propozimin e bashkangjitur në RVKE, për të qenë pjesë e diskurseve publike mbi hartimin e zgjidhjeve ligjore, etj.

Kush do të ftohet për të marrë pjesë në grupin e punës për ndryshimin/plotësimin e ndonjë ligji/akti nënligjor varet nga përmbajtja e propozimit. Të anketuarit pohojnë se të gjitha palët e prekura dhe organizatat aktive qytetare (OShC), të cilët kanë ekspertizën dhe kompetencën për të dhënë kontributin e tyre në miratimin e projekt-ligjit, thirren në terren.

Në shumicën e ministrive ekziston një person përgjegjës, departament përgjegjës për analizimin dhe monitorimin e rregullores evropiane dhe transpozimin e duhur në legjislacionin kombëtar. Por shumë shpesh, personet përgjegjës për VNRr ose nuk janë të përfshirë në procesin e analizës, ose nuk mund të përfshihen, sepse ka shumë ligje dhe pak kapacitete njerëzore për të arritur gjithçka që është konceptuar dhe që është e detyrueshme.

Shumica e të anketuarve argumentojnë se gjatë grumbullimit të të dhënave nga subjektet e tjera (duke përfshirë edhe organet e tjera të administratës shtetërore) që janë të nevojshme për zbatimin e duhur të procesit të VNRr-së, ata përballen me rreziqe dhe sfida të caktuara. Më shpesh, informacioni që ata marrin është i vonuar, i paplotë, i papërshtatshëm, ose në asnjë mënyrë nuk jepet informacion.

Ajo që të anketuarit përfundojnë është se nevojiten më shumë njerëz për të punuar në procesin e VNRr-së dhe personat përgjegjës në të gjitha ministritë që të jenë sekretarët shtetërorë. Përveç kësaj, kërkohet trajnim i vazhdueshëm për personat të cilët e zbatojnë procesin në mënyrë që të kuptohet dhe zbatohet më mirë. Një problem tjetër përmend afatet e shkurtra për zbatimin e procesit dhe përgatitjen e rregulloreve, si dhe procedurat burokratike që ekzistojnë dhe pengojnë punën e koordinatorëve dhe zëvendësve të tyre.

3. Praktikat më të mira në zbatimin e VNRr-së - Analiza krahasuese

3.1 Zbatimi dhe rëndësia e VNRr-së në BE

Komisioni Evropian përcakton procesin e VNRr si: "Vlerësimi i ndikimit të rregullores është një tërësi hapash logjikë që duhet të ndiqen në përgatitjen e propozimeve të politikave. Është një proces i përgatitjes së provave për politikëbërësit e politikave publike në lidhje me përparësitë dhe mangësitë e zgjidhjeve të mundshme përmes një vlerësimi të ndikimit të mundshëm të kësaj politike. Rezultati i këtij procesi është përmbledhur dhe paraqitur në raportin nga VNRr".[32]

Ajo që duhet të theksohet është se "në BE, ajo që do të bëhet gjatë zbatimit të VNRr-së është elementi themelor në zhvillimin e propozimeve të Komisionit Evropian, dhe komisionerët marrin parasysh raportin nga VNRr në vendimmarrje. VNRr mbështet, por nuk zëvendëson, procesin e vendimmarrjes, për arsye se miratimi i një politike është një vendim politik i bërë nga Komisioni ".

32 SEC(2009)92, Impact assessment guidelines, European Commission, January 15th 2009, page 5.

VNRr ka origjinën në praktikën e vendeve të OECD-së, të tilla si Shtetet e Bashkuara (ku VNRr fillon të aplikohet nga viti 1974) dhe Australia (ku VNRr fillon të zbatohet nga 1985). Tani, 34 nga 35 vendet e OECD përdorin VNRr si një metodë të bazuar në vendimmarrje në hartimin e politikave dhe rregulloreve. [33] BE vendos të inkorporojë VNRr në vendimmarrje nga mbledhjet e mbajtura të Këshillit Evropian në Göteborg (2001) dhe në Laeken (2001). Fillimi i zbatimit të VNRr është një element thelbësor i Rregullave për rregullim më të mirë [34], që nga atëherë azhurohet rregullisht (2015, 2017) dhe zëvendëson llojin e vjetër të vlerësimit të rregullores që ka bërë vetëm sektori që duhet të zbatojë politika konkrete.

Hapat kryesorë analitikë të VNRr-së përbëhen nga: 1) Identifikimi i problemit; 2) Përcaktimi i objektivave; 3) Zhvillimi i zgjidhjeve të mundshme për rregullimin e politikave publike; 4) Analiza e ndikimit të zgjidhjeve të mundshme; 5) Krahasimi me mundësitë e tjera; 6) Përgatitja e një plani monitorimi dhe vlerësimi. Kur është fjala për të ndikimin e vlerësimit, VNRR përbëhet nga tre hapa: 1) Identifikimi i ndikimeve ekonomike, sociale dhe ndikimit në mjedis, 2) Vlerësimi cilësor të më të rëndësishmes së këtyre ndikimeve, 3) Analizë e thellë cilësore dhe sasiore të ndikimeve më të rëndësishme. VNRr synon të përfshijë palë të ndryshme në proces që të arrihet efikasiteti më i lartë i politikës publike që duhet arritur.[35]

Sektori drejtues për miratimin e propozimit është përgjegjës për përgatitjen e VNRr-së. Sektorit, ndër të tjerat, i nevojitet kontributi nga palet e interesuara dhe në shumicën e rasteve nevojitet ekspertiza e brendshme dhe e jashtme. Shërbimet e tjera të Komisionit, duke përfshirë Sekretariatin e përgjithshëm ofrojnë vetëm mbështetje gjatë zbatimit të VNRr-së të grupeve të ndryshme për vlerësimin e ndikimit dhe konsultimet ndër-sektoriale. Bordi i Kontrollit Rregullator (the Regulatory Scrutiny Board), i cili kontrollon cilësinë e VNRr-së të implementuar, gjithashtu mund të ofrojë mbështetje dhe këshilla në përgatitjen e raporteve, para se të jenë finalizuar.[36]

Bordi i Kontrollit Rregullator të BE (BKR) është një organ i pavarur brenda Komisionit, i cili vlerëson raportet e paraqitura për VNRr. Ky bord vjen në vend të Bordit të Vlerësimit të Ndikimit, i cili më parë ka vlerësuar dhe kontrolluar zbatimin e politikës publike ex-ante. Tani, BKR gjithashtu vlerëson VNRR, por gjithashtu kontrollon ndikimin e politikës/ rregullimit pas zbatimit/ implementimin të saj. Bordi përbëhet nga 3 punonjës të Komisionit dhe 3 ekspertë individualë. Ai publikon raporte vjetore mbi rezultatet dhe aktivitetet e tij.

